

VENDIM
QARKULLUES
Nr. 34, datë 28.5.2020

PËR NJË NDRYSHIM NE VENDIMIN PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES “PËR TRAJTIMIN JASHTËGJYQËSOR NGA BANKAT, TË
KREDIMARRËSVE NË VËSHTIRËSI FINANCIARE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të neneve 57, pika 2, 58, pika 1, shkronja “c”, 61, 66/1, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtyrjen e efekteve të rregullores nr. 51, datë 3.7.2019, “Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredimarrësve në vështirësi financiare”, deri në datën 1.1.2022.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko